
AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BOSS AUTO” SHPK

06.04.2021

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ BOSS AUTO” SHPK

KREU I

EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ BOSS AUTO” SHPK. (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

NENI 2

SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bashkia Kamez , Rruga “Bulevardi Blu,Kamez - Tirane , Shqipëri.
- 2.2 Ortakt mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar.

NENI 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

Aktivitete: Blerje dhe Shitje Autovetura

- 4.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm

për realizimin e qëllimeve të saj.

- 4.3 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja, si edhe të hyje në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj.

KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është prej 100.00 (njëqind) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuote me vlere nominale 100.00 (një qind) Leke, që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar, kapital i cili është nënshkruar dhe paguar tërësisht nga Ortakët e shoqërisë:

Z. Sami Nezir Kapica (50%)

Z. Jetmir Bajram Çelaj (50%)

NENI 6

TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT

- 6.1 Kuotat e shoqërisë mund tu transferohen lirisht të tretëve në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 7

BARRËT MBI KUOTAT E KAPITALIT

- 7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale.

KREU III

ORTAKËT, FINANCIMET

NENI 8

ORTAKËT

- 8.1 Ortakët e Shoqërisë janë Z. Sami Nezir Kapica dhe Z. Jetmir Bajram Çelaj , përkatësisht:

Z. Sami Nezir Kapica shtetas shqiptar, lindur në Tregtan-Kukes, më 12/10/1973, mbajtës i ID me nr.H31012016M banues në adresën: Rr. Albanes,Banese private,Kamez-,, Tiranë, Shqipëri;

Z. JetmirBajram Çelaj shtetas shqiptar, lindur në Tropoj, më 28/03/1987, mbajtës i I D me nr. I70328128S banues në adresën:, Rruga Selaniku,Pallati nr 3,SHK 1/6 Kamez-Tirane, Shqipëri;

NENI 9

VENDIMET E ORTAKUT TË VETËM

- 9.1 Ortakët e Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar marrin vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii) kalimin e kuotave të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon Ortakëve të Shoqërisë.
- 9.2 Vendimet e Ortakëve të Shoqërisë duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

NENI 10

FINANCIMI I SHOQËRISË

- 10.1 Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejte të kërkojë nga ortakët e shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 10.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto фонде.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 11

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 11.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i cili emërohet nga ortakët e shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të emërojnë, apo pushojnë në çdo kohë Administratorin.
- 11.2 Si Administrator i Shoqërisë emërohet:
- Z. **Sami Kapica**, shtetas shqiptar, lindur ne Tregtan-Kukes me 12/10/1973, mbajtës i I D me nr. H31012016M banues në adresën: Rr. Albanes,Banese private,Kamez-., Tiranë, Shqipëri;
- Tiranë, Shqipëri.
- 11.3 Administratori i vetëm përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe private, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatimore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.
- 11.4 Administratori vepron në përputhje me politikat e biznesit të përcaktuara nga Ortakët e Shoqërisë. Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakëve të Shoqërisë apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 11.5 Administratori është përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Administratori mund t'ua delegojë palëve të treta tagrat e lidhura me administrimin e Shoqërisë. Administratori mbetet përgjegjës i drejtpërdrejtë për të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesit në lidhje me administrimin e Shoqërisë.
- 11.6 Administratori do të veprojë gjatë gjithë kohës në interes të Shoqërisë. Në rast të një konflikti interesi, Administratori do të informojë menjëherë Ortakët e Shoqërisë, dhe nuk do të kryejë asnjë veprim lidhur me çështjen objekt i konfliktit të interesit, deri në pajisjen me udhëzimet përkatëse nga Ortakët e Shoqërisë.

NENI 12

SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORËVE

- 12.1 Ortakët e Shoqërisë përcaktojnë shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

KREU V

KONTROLI KONTABËL I SHOQËRISË

VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 13

KONTROLI KONTABËL

- 13.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortakët e Shoqërisë do të emërojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 14

VITI FINANCIAR

- 14.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 15

BILANCI VJETOR DHE REZERVAT

- 15.1 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Ortakët e Shoqërisë të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- 15.2 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventarët, raportet e Administratorit dhe Ekspertit Kontabël miratohen nga ortakët e Shoqërisë. Administratori i paraqet Ortakëve të Shoqërisë për miratim, raportin mbi administrimin e Shoqërisë si dhe pasqyrat financiare vjetore.

- 15.3 Ortakët e Shoqërisë vendosin mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.
- 15.4 Ortakët e Shoqërisë në çdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

KREU VI
PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 16
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 16.1 Në rastin e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 17
NJOFTIMET

- 17.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.
- 17.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 17.3 Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

KREU VII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 18
LIGJI I ZBATUESHEM

- 18.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me parashikimet e këtij Akti Themelimi, Statuti dhe legjislacionit shqiptar. Për të gjitha ato çështjet që nuk janë parashikuar në këtë dokument, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar mbi shoqëritë tregtare.

NENI 19

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 19.1 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve të saj, ose ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të tyre, dhe/ose Shoqërisë, lidhur me interpretimin dhe / ose zbatimin e këtij Akti Themelimi dhe Statuti, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 20

GJUHA

- 20.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut përpilohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe.

Për ORTAKET :

Z. Sami Nezir Kapica

Z. Jetmir Barjam Çelaj

